REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



ZGJEDHJE PRESIDENCIALE 2014

DORACAK PËR EDUKIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

MESAZHI I KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Të nderuar anëtar të komisioneve komunale të zgjedhjeve,

Vetëm zgjedhjet të cilat kanë kredibilitet dhe i respektojnë parimet e demokracisë dhe qeverisjes së mirë kontribuojnë në zhvillimin demokratik të shoqërisë. Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, me zbatimin e suksesshëm të zgjedhjeve vendosë fondamentin e demokracisë dhe kontribuon në zhvillimin dhe mirëbesimin e sistemit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë. Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, në mënyrë kontinuale përpiqet të shfaq shembull dhe të mbajë reputacion si organ zgjedhor i pavarur, i paanshëm dhe me përgjegjësi.

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, në çdo rast është i përgatitur që të realizoj zgjedhje të cilat janë në përputhje me normat demokratike ndërkombëtare, gjatë të cilave është i përcaktuar për ndjekjen e principit të ciklit zgjedhor. Një nga hallkat më kryesore në zinxhirin e realizimit të atyre qëllimeve është edhe komisioni komunal i zgjedhjeve. Si anëtar të tyre pikërisht jeni ju ata të cilët mbani pjesë të barrës, përgjegjësisë por edhe meritat dhe nderin për realizim të suksesshëm të zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, pritjet nga Ju janë të larta, por mirënjohja për realizimin e tyre është akoma edhe më e lartë.

Pjesëmarrja e përbashkët në procesin e bartjes së nivelit të lartë të demokracisë, është vlerë e paçmuar.

Edhe një herë do ta verifikojmë dhe do ta përforcojmë rolin tonë në shoqërinë demokratike të Republikës së Maqedonisë, duke siguruar kushte të barabarta të zgjedhjeve për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe liri dhe fshehtësi e njëjtë e votës për secilin zgjedhës.

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
KRYETAR
Nikola Rilkoski

PËRMBAJTJA

KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE DHE KOMISIONI ZGJEDHOR I QYTETIT TË SHKUPIT

ZGJEDHJA DHE PËRBËRJA 5

KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE DHE KZQSH 6

1. KOMPETENCAT E KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME KËSHILLAT ZGJEDHOR DHE VENDVOTIMET 6
2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE 6
3. KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME INFORMIMIN E OPINIONIT 7
4. KOMPETENCAT E TJERA TË KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 7

PERSONAT TË CILËT MUND TA VËZHGOJNË PUNËN E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

1. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARASHTRUESËVE SË LISTAVE TË KANDIDATËVE 8
2. VËZHGUESIT E AKREDITUAR 8
3. GAZETARËT 9

ORGANIZIMI I PUNËS SË KKZ-së

TAKIMI ME PËRFAQËSUESIT E VETËQEVERISJES LOKALE 10

TË DHËNAT TË CILAT I DORËZONI NË KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE 10

SEANCA E PARË E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE - PLANIFIKIMI 11

SEANCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 14

PUNA ARKIVORE E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 14

BASHKËPUNIMI ME POLICINË 17

EDUKIMI I DETYRUESHËM I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 18

PUNA FINANCIARE E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 18

KOMPETENCAT LIDHUR ME KËSHILLAT ZGJEDHOR

FORMIMI I KËSHILLAVE ZGJEDHOR 19

1. PËRBËRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR 19
2. SHKAQET E MARRJES SË EMËRIMIT TË ANËTARIT TË ZGJEDHUR TË KZ 20
3. CILI NUK MUND TË JETË ANËTAR I KËSHILLIT ZGJEDHOR? 20
4. SI VEPRON KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE? 20

PLANI DHE ORARI I EDUKIMIT TË DETYRUESHËM TË KËSHILLAVE ZGJEDHOR 22

AKTIVITETET TJERA NJË DITË PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

MENAXHIMI ME MATERIALIN ZGJEDHOR 23

1. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NGA KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE NË KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE 24
2. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NGA KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE NË KËSHILLAT ZGJEDHOR 24

PRANIMI I NJOFTIMEVE PËR VOTIM TË PERSONAVE TË SËMURË OSE TË PA AFTË, PËRKATËSISHT PERSONA TË CILËT GJENDEN NË VUAJTJEN E MASAVE-BURG SHTËPIAK.. 25

AKTIVITETET NË DITËN E VOTIMIT

AKTIVITETET PARA FILLIMIT TË VOTIMIT 26

AKTIVITETET NË PERIUDHËN PREJ ORËS 07:00 DERI NË ORA 19:00 26

1. BASHKËPUNIMI ME ORGANET TJERA ZGJEDHORE 26
2. SHKARKIMI I ANËTARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR 27
3. MBLEDHJA E TË DHËNAVE PËR DALJEN E VOTUESVE 27
4. BASHKËPUNIMI ME VOTUESIT 27
5. ZBATIMI I VOTIMIT TË ZGJEDHËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA 27

AKTIVITETET PAS PËRFUNDIMIT TË VOTIMIT 28

1. PRANIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR 28
2. SUMIMI DHE KONFIRMIMI I REZULTATEVE 29

PAKETIMI I MATERIALEVE PËR DORËZIM NË KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE ... 30

KONTRIBUTI I KKZ-së NË MBROJTJEN E TË DREJTËS ZGJEDHORE 32

KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE DHE KOMISIONI ZGJEDHOR I QYTETIT TË SHKUPIT

Kodi zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve presidenciale i parasheh këto lloje të organeve:

- Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë KSHZ)
- Komisioni komunal i zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë KSHZ)
- Këshillat zgjedhor (në tekstin e mëtejmë KZ) dhe
- Këshillat zgjedhor të votimit në përfaqësitë diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë (KZ-PDK).

ZGJEDHJA DHE PËRBËRJA

KKZ formohen me vendim të KSHZ-së. Në territorin e Republikës së Maqedonisë si organe të përhershme zgjedhore, formohen 80 Komisione komunale të zgjedhjeve të cilat ndërmarrin aktivitete për zbatim të suksesshëm të procesit zgjedhor dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, i cili ndërmerr aktivitete vetëm në rast të zgjedhjeve lokale.

KKZ, përbëhet nga kryetari dhe zëvendësi tij dhe katër anëtarë si dhe zëvendësit e tyre. Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe zëvendësanëtarët, zgjidhen me zgjedhje të rastit nga radhët e administratës shtetërore, komunale dhe administratës së qytetit të Shkupit me mandat pesë vjeçar.

Për çdo komunë formohet e KKZ-ë e veçantë. KKZ-ja është kompetente për zbatimin e veprimeve zgjedhore në njësinë zgjedhore dhe në vendvotimet e përcaktuara sipas Kodit zgjedhor, përkatësisht në territorin e komunës për të cilën është formuar

KKZ ka sekretar dhe zëvendës të tij. Sekretari dhe zëvendëssekretari janë nga radhët e juristëve të diplomuar me kohëzgjatje për 5 vjet.

KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE DHE KZQSH

Komisioni komunal i zgjedhjeve kujdeset për ligjshmërinë e përgatitjes dhe zbatimit të zgjedhjeve në pajtim me kodin zgjedhor dhe kryen mbikëqyrjen e punës së këshillave zgjedhorë.

1. KOMPETENCAT E KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME KËSHILLAT ZGJEDHOR DHE VENDVOTIMET:

- Emëron përbërjen e KZ-së;
- Jep udhëzime për punën e KZ-së;
- Para çdo zgjedhje sipas planit dhe programit të KSHZ-së organizon dhe zbaton edukim të detyrueshëm për anëtarët e KZ-së dhe për trajnimin e kryer iu ndanë certifikata.
- Është i detyruar që në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet në kompetencat e tij të jenë të hapura në ora 7:00;
- Kontrollon ligjshmërinë e punës së KZ-së, intervenon në raste ku konstatohet cenimi i ligjshmërisë në përgatitjet, zbatimin dhe konfirmimin e rezultateve të zgjedhjeve, cenimi i rekomandimeve të dhëna, shkarkon anëtarët e KZ-së në rast të punës së tyre të paligjshme para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve;
- Një ditë para zgjedhjeve në mënyrën e përcaktuar në Kodin zgjedhor, KZ-së i dorëzon materialin zgjedhor;
- Pas përfundimit të zgjedhjeve nga KZ-të, mbledh materialin zgjedhor dhe procesverbalet me rezultatet zgjedhore,

2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE:

- Sipas rekomandimeve dhe instruksioneve të KSHZ-së ndërmerr përgatitje teknike për zbatimin e zgjedhjeve;
- Përgatit raport për punën e KKZ-së -së pas zbatimit të zgjedhjeve dhe e dorëzon në KSHZ.;
- KKZ-ja, pas zbatimit të zgjedhjeve në afat prej pesë orëve pas pranimit të materialit të tërësishëm zgjedhor na KZ-të, sumon rezultatet e votimit të listave të kandidatëve në vendvotimet sipas përkatësisë së tyre të njësisë zgjedhore, për të cilët është kompetent, i përpilon procesverbale dhe i dorëzon në KSHZ.;

- Siguron materiale dëshmuese gjatë vendimit sipas mjeteve juridike;
- Në KSHZ dorëzon njoftim ku ceken vendvotimet të cilat nuk janë hapur në ora 07:00 si dhe shkaqet e mosëhapjes së tyre si dhe masat që do të merren për mënjanimin e parregullsive.

3. KOMPETENCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME INFORMIMIN E OPINIONIT:

- I informon qytetarët për vendin e votimit;
- Në vende të dukshme të komunës i shpallë listat e verifikuara të kandidatëve.

4. KOMPETENCAT E TJERA TË KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE:

- I evidenton dhe i verifikon përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve për ndjekjen e punës së KKZ-së dhe KZ dhe ju ndan bexhe me numrin e vendvotimit.
- Për nevojat e Entit shtetëror të statistikës plotëson dhe dorëzon të dhëna statistikore.
- Pranon dhe vendos për njoftimet e personave të sëmurë dhe të paaftë si dhe për të njëjtët sipas vendvotimeve përpilon listë.

PERSONAT TË CILËT MUND TA VËZHGOJNË PUNËN E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

Personat të cilët kanë të drejtë që ta vëzhgojnë punën e KKZ-së mund t'i ndajmë në tre grupe:

1. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARASHTRUESËVE SË LISTAVE TË KANDIDATËVE

Secili parashtrues i listës së kandidatëve, që nga fillimi i zgjedhjeve deri në konfirmimin dhe shpalljen e rezultateve, ka të drejtë të përcaktoj PËRFAQËSUES DHE ZËVENDËS TË TIJ që do ta ndjek punën e KKZ-së.

Parashtruesi i listës, përfaqësuesit i jep AUTORIZIM, dhe për këtë, më së voni dy ditë para ditës së zgjedhjeve e njofton KKZ-së.

Përfaqësuesit e autorizuar e parashtruesit të listës kanë të drejtë:

- Në seancat e KKZ-së- të kërkojnë të zbatohet shikim në dokumentacionin e tërësishëm të Komisionit;
- Në seancën e KKZ-së të jep vërejtje për parregullsitë në punën e KKZ-së;
- Të kërkoj që vërejtja të shënohet në procesverbalin e seancës së KKZ-së.

Përfaqësuesi i autorizuar dhe zëvendësi i tij para KKZ-së nuk mund të jetë person i verifikuar për kandidat. Në seancën e KKZ-së, në vëzhgimin e punës mund të jetë i pranishëm vetëm përfaqësuesi i autorizuar ose zëvendësi i tij, i secilës listë të verifikuar të kandidatëve.

2. VËZHGUESIT E AKREDITUAR

Vëzhguesit e akreditуar (vendor dhe ndërkombëtarë) në KKZ legjitimohen me:

- BEXH për vëzhgues të cilin e lëshon KSHZ-ja, ndërsa ata janë të detyruar ta mbajnë me vete dhe
- Dokument për identifikim personal.

Vëzhguesit e akreditуar mund ti vëzhgojnë përgatitjet dhe zhvillimin e zgjedhjeve në të gjitha aspektet dhe janë të detyruar:

- Ta respektojnë Kodin zgjedhor dhe rekomandimet e KSHZ-së, që i përkasin vëzhgimit të procesit zgjedhor;
- Ta respektojnë Kodeksin e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe procedurës zgjedhore (shpallur në ueb faqen e KSHZ-së);
- Të legjitimohen me bexhin e vëzhguesve;
- Të mos përzihen në aktivitetet dhe punën e organeve që i zbatojnë zgjedhjet.

3. GAZETARËT

Gazetarët VENDOR në KKZ legjitimohen me:

- Akreditim i lëshuar nga shtëpia gazetareske e tij, nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ose Asociacioni i gazetarëve të Maqedonisë (AGM) dhe
- dokument për identifikim personal

Gazetarët e HUAJ të akreditуar legjitimohen me bexh lëshuar të KSHZ-së.

Gazetarët e akreditуar vendor dhe të huaj, kanë të drejtë të ndjekin punën e KKZ-së, me kusht që atë të mos e pengojnë.

Kryetari i KKZ-së ose zëvendësi i tij, para gazetarëve mund të jep DEKLARATË VETËM PËR INFORMACIONE TEKNIKE RRETH PROCESIT ZGJEDHOR (p.sh. numri i zgjedhësve të regjistruar në listën zgjedhore,numri dhe lokacionet e vendvotimeve, numri i personave të sëmurë ose të paaftë të cilët kanë parashtruar njoftim në KKZ, të dhënat e daljes së votuesve deri në momentin e deklaratës etj.) Kryetari i KKZ-së, zëvendësi i tij, anëtarët ose zëvendës anëtarët për deklaratë në lidhje me çështjen e rrjedhjes së procesit zgjedhor gazetarët i drejtojnë në KSHZ.

ORGANIZIMI I PUNËS SË KKZ-së

TAKIMI ME PËRFAQËSUESIT E VETËQEVERISJES LOKALE

Kryetari dhe zëvendëskryetari para se të mbahet seanca e parë, pas shpalljes së zgjedhjeve organizojnë takim me kryetarin e komunës ose me personin i cili është i emëruar për kontakt dhe logjistikë me KKZ .

Kryetari i komunës është i detyruar të siguroj lokale të cilët KKZ-ja do t'i shfrytëzojë gjatë kohës së procesit zgjedhor si dhe ndihmë dhe pajisje tjera teknike.

ME RËNDËSI: *Adresën e saktë të lokaleve të cilat do t'i shfrytëzoj Komisioni Komunal i Zgjedhjeve MENJËHERË e dorëzoni në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (në e-mail: izbori@sec.mk) për instalimin e linjës telefonike dhe internetit.*

VENI RE: *Nëse komuna nuk siguron kushte teknike, lokale etj për punën e komisionit komunal të zgjedhjeve, për këtë menjëherë duhet ta njoftoni Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve që të mund të ndërmerr aktivitete për sigurimin e kushteve të duhura të punës.*

TË DHËNAT TË CILAT I DORËZONI NË KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Nëse nuk e keni bërë këtë, në e-mail: edukacija@sec.mk MENJËHERË dorëzoni tabelën e plotësuar në vijim:

FUNKSIONI	EMRI	MBIEMRI	KONTAKT TEL.	E-MAIL ADRESA
Kryetar				
Zëvendëskryetar				
Anëtar				
Anëtar				
Anëtar				
Anëtar				
Zëvendësanëtar				
Zëvendësanëtar				
Zëvendësanëtar				
Zëvendësanëtar				
Sekretar				
Zëvendëssekretar				

Nëse në përbërjen tuaj të KKZ-së ka ndonjë ndryshim (p.sh. ndonjë anëtarë ka humbur statusin e nëpunësit shtetëror etj.) për këtë me shkresë do ta njoftoni Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, që të ndërmerr veprimet e duhura për plotësimin e KKZ-së.

ME RËNDËSI: *Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët, zëvendësanëtari, zëvendëssekretari i komisioneve komunale të zgjedhjeve si dhe kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillave zgjedhor janë të detyruar që të nënshkruajnë deklaratë për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të gjitha deklaratat e nënshkruara ruhen në një zarf të veçantë në lokalet e komunës, ku ruhet materiali i besueshëm dhe materialet tjera zgjedhore.*

SEANCA E PARË E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE - PLANIFIKIMI

Në seancën e parë të KKZ-së të pranishëm janë:

1. kryetari,
2. zëvendëskryetari,
3. anëtarët dhe zëvendësanëtarët,
4. sekretari dhe zëvendëssekretari.

Seanca e parë të KKZ-së i dedikohet planifikimit të aktiviteteve gjatë procesit zgjedhor. Për këtë arsye duhet të jenë të pranishëm gjithë përbërja e KKZ-së dhe të kyçen në punën e planit detal të aktiviteteve.

Për përpunimin e planit të aktiviteteve të KKZ-së shfrytëzoni:

Kalendari i afateve i cili është miratuar dhe shpallur në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (http://www.sec.mk). Kalendari i afateve do t'u shërbejë që saktësisht të dini datën kur duhet të përfundojë veprimi zgjedhor. Nëse ju duhet përkrahje plotësuese për ndonjë nga teknikat e planifikimit që ju prezentuan në punëtoritë e planifikimit dhe buxhetit në vitin 2012 drejtohuni në e-mailin: edukacija@sec.mk.

Gjatë përpunimit të planit duhet të keni parasysh këto pyetje:

1. ÇKA, përkatësisht CILAT aktivitete duhet përfunduar që të finalizohet i tërë procesi?
2. KUR dhe SIPAS CILËS RRADHITJE duhet të mbarojnë këto aktivitete?
3. CILI për secilin aktivitet do të jetë përgjegjës?

Që të arrihet deri te përgjigjja e këtyre pyetjeve, duhet të përgjigjeni edhe në disa pyetje plotësuese:

1. Sa kohë do të duhet për çdo aktivitet ndaras?
2. Si është varësia e aktiviteteve mes vete, përkatësisht a varet nisja e një aktiviteti me mbarimin e aktivitetit tjetër?
3. Cili ka dije /aftësi/ kohë për aktivitet përkatës?
4. Cilat janë rreziqet e jashtme (p.sh koha e porositjes së materialit, kushte të pavolitshme klimatike, dhe të ngjashme)?

Plani i përpunuar duhet ta përcaktojë:

- Kohën në mënyrë të qartë dhe lineare,
- Ti përfshijë të gjitha aktivitetet, si dhe relacionin e tyre me aktivitetet tjera,
- Afatet ti përcaktoj në mënyrë të qartë,
- Të jetë në shikim të tërë ekipit,
- Të përcaktoj përgjegjësi individuale për secilin për aktivitetin e "tij".

PLANI I PËRPILUAR I AKTIVITETEVE ËSHTË PJESË PËRBËRËSE E RAPORTIT FINAL TË PUNËS SË KKZ-së

PLANIN E PËRPUNUAR TË AKTIVITETEVE DORËZOJENI MENJËHER NË KSHZ!

GJATË PËRGATITJES TË PLANIT PATJETËR DUHET TË JETË E KYÇUR TËRË PËRBËRJA E KKZ-së!

Gjatë përgatitjes së planit të aktiviteteve në seancën e parë të KKZ-së gjithashtu përcaktohet edhe angazhimi i zëvendësanëtarëve dhe zëvendëssekretarit.

Për angazhimin e të gjithë anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të KKZ-së mbahet evidencë precize, e cila i bashkëngjitet raportit final të punës së KKZ-së. Evidenca duhet të jetë në pajtim me planin e aktiviteteve të KKZ-së. Evidenca mbahet në FORMULAR TË VEÇANTË PËR PJESËMARRJE NË PUNË, i cili është shtojcë e raportit financiar të punës së KKZ-së dhe pjesë përbërëse e Udhëzimit të mënyrës së realizimit të mjeteve të përcaktuara të KSHZ-së, për zbatimin e zgjedhjeve nga ana e Komisioneve komunale të zgjedhjeve.

Formular i pranisë në punë (FPP)

Mbiemri:						Lloj i kontratës :	
Emri:						Ditore:	Niveli:
Funksioni:							
KKZ:						Kontratë në vepër:	Tjera:
Muaji/viti:							
Data	Orari i punës		gjithsej orë	Angazhimi jashtë vendit të punës	Urdhëresë udhëtimi		Qëllimi dhe vendi i angazhimit	Nënshkrimi i personit të autorizuar për vërtetimin e angazhimit
	fillimi	mbarimi			Koha prej	Koha deri		
01								
02								
03								
04								
05								
...								
30								
31								
Angazhimet e tërësishme në orë								

Nënshkrimi i personit të angazhuar

Nënshkrimi i personit përgjegjës
Kryetari i KKZ-së

Data:

SEANCAT E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

KKZ, nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve e deri në përfundimin e tyre është përherë në mbledhje. KKZ-ja punon në seanca. Për çdo seancë përpilon procesverbal të veçantë. Kopjet nga të gjithë procesverbalet i bashkëngjiten procesverbalit final për punën e KKZ-së i cili dorëzohet në KSHZ. Procesverbali për 5 vitet e ardhshme ruhet në arkivin e KKZ-së. KSHZ-ja e njofton KKZ -në se në cilin afat KKZ-ja është detyruar ta dorëzojë raportin.

Seanca e KKZ	---------->	Procesverbali nga seanca	---------->	Në shtojcë raporti final i punës

Në punën dhe diskutimet e KKZ-së rregullisht janë të pranishëm zëvendëskryetari dhe sekretari, mirëpo pa të drejtë vote në vendimmarrje. Zëvendëskryetari në vendimmarrje merr pjesë vetëm atëherë kur në seancë mungon kryetari.

Në prani të anëtarit, zëvendësanëtari nuk ka të drejtë në pjesëmarrje të vendimmarrjeve të KKZ-së.

KKZ punon dhe vendos vetëm nëse në seancë janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Vendimet miratohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Në rast të mungesës së anëtarit, në punën e seancës është i pranishëm zëvendësi i tij.

PUNA ARKIVORE E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

Punët profesionale-administrative dhe organizative-teknike të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në të cilën përfshihet edhe puna arkivore, i kryen sekretari ose zëvendëssekretari i KKZ-së. Të gjitha aktet që rrjedhin nga puna e komisionit komunal të zgjedhjeve, sekretari ose zëvendëssekretari i KKZ-së i regjistron në LIBËR AFARIST.

Libri afarist i përmban këto rubrika:

Numri themelor	LËNDA	Nën -numrat	Data e pranimt	DËRGUES		Njësia organizative	SHKURORËZIM	
				Emri dhe mbiemri përkatësisht emërimi i vendit	Numri Data		Data	SHENJA
1	2	3	4	5	6	7	8	9
Transfer:								

Rubrika 1:

- Të gjitha aktet dhe shtojcat të cilat i përkasin të njëjtës çështje, përfaqësojnë TËRËSI TË VEÇANTË dhe udhëhiqen me të NJËJTIN NUMËR
- Numri i parë themelor në Rregulloren e KKZ është numri 1
- Në vazhdim si numra themelor përdoren numrat 2, 3, 4, 5 etj.

Rubrika 2:

- Shënohet emërimi i tërësishëm i aktit(Shiko shembullin)
- Në një fushë mund të shënohen DERI TRE akte të cila udhëhiqen nën të njëjtin numër themelor
- Nëse përshkrimi vazhdon më shumë se tre akte, aktet në vijim shënohen në fushën e parë të lirë në Rregullore, por nuk përmbajnë TË NJËJTIN NUMËR dhe kontuinitet të nën-numrave

Rubrika 3:

- Secili akt e merr në lidhje me NUMRIN THEMELOR nën-numër të veçantë
- Nëse bëhet fjalë për aktin e parë i cili përmban numër themelor të përcaktuar, si nën-numër merr numrin 1 etj (shiko shembullin)

Rubrika 4:

- Nëse KKZ e jep aktin, shënohet data e dhënies
- Nëse KKZ pranon akt, shënohet data e pranimit

Rubrika 5:

- Nëse KKZ e jep aktin ,shënohet „NP“
- Nëse KKZ pranon akt, shënohet emri dhe mbiemri i tërësishëm përkatësisht emërimi dhe vendi i dërguesit

Rubrika 6:

- Nëse KKZ e dorëzon aktin nuk shënohet asgjë
- Nëse KKZ pranon akt shënohet numri dhe data i dokumentit të pranuar nga dërguesi

Rubrika 7:

- Për gjitha aktet lidhur me zgjedhjet Presidenciale shënohet 09
- Për aktet lidhur me çështjet financiare shënohet 05
- KKZ nuk përdorë njësi të tjera përveç 09 dhe 05!

Rubrikat 8 dhe 9:

- Për shembull: Nuk plotësohet

Numri themelor	LËNDA	Nën-numrat	Data e pranimit	DËRGUES		Njësia organizative	NDARJE (shkurorëzim)	
Transfer:				Emri dhe mbiemri përkatësisht emërimi dhe vendi	Numri data		data	SHENJA
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	- njoftim i KSHZ për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve financiare	1	01.03	„NP“		05		
Transfer:	- Përgjigje e njoftimit	2	07.03	KSHZ	05-11/1; 20.05.	05		
2	RAPORTI PËR PUNËN e KKZ	1	15. 0.4	„NP“		09		
Transfer:								

Në pajtim me shembullin:

Kërkesa deri në KSHZ për mjete financiare është me:

numër	05	-	1	/	1	nga	1.03.2014
	Njësia organizative		Numri themelor		Nën-numër		

Përgjigjja e kërkesës me:

numër	05	-	1	/	2	nga	7.03.2014
	Njësia organizative		Numri themelor		Nën-numër		

Raporti i punës së KKZ është me:

numër	09	-	2	/	1	nga	15.04.2014
	Njësia organizative		Numri themelor		Nën-numër		

BASHKËPUNIMI ME POLICINË

Kryetari i komisionit komunal të zgjedhjeve, pas mbajtjes së seancës së parë duhet të kërkoj takim me personin përgjegjës të MPB-së në komunë.

Në takim duhet të shtjellohen këto çështje:

- Prania e policisë gjatë pranimit të materialit zgjedhor nga KSHZ-ja .
- Ruajtja e materialit zgjedhor deri në momentin e dorëzimit në gjitha këshillat zgjedhor që janë nën kompetencat e KKZ-së.
- Sigurimi i vendvotimeve pas dorëzimit të materialit zgjedhor të KZ-ve:
- Sigurimi i vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve (pandërprerë prej ora 06:00 deri 19:00)
- Sigurimi i KZ-së dhe vendvotimit gjatë kohës së sumimit të rezultateve
- Sigurimi i KZ-së deri në dorëzimin e procesverbalit dhe materialeve tjera nga vendvotimi në komisionin komunal të zgjedhjeve.

Kryetari i komisionit komunal të zgjedhjeve dhe personi përgjegjës i MPB-së, gjatë bashkëpunimit duhet të këmbejnë lista me numra të telefonave të:

- Kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të këshillave zgjedhore
- Përfaqësuesit e policisë të cilët do të jenë të angazhuar në vendvotime në ditën e zgjedhjeve.

Kjo, me qëllim që të mundësohet komunikimi në mes këshillave zgjedhore dhe përfaqësuesve të policisë në ditën e zgjedhjeve.

EDUKIMI I DETYRUESHËM I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

KSHZ-ja, miraton Program për edukimin të detyrueshëm të KKZ-ve, dhe përpilon standarde për edukimin e detyrueshëm e të gjitha organeve zgjedhore. KSHZ-ja përpilon orar për edukimin e detyrueshëm dhe e njofton kryetarin, përkatësisht zëvendëskryetarin e KKZ-së për ditën dhe vendin e mbajtjes së trajnimit. Orari dhe temat për edukimin e detyrueshëm shpallen në ueb faqen e internetit të KSHZ-së www.sec.mk .

KSHZ-ja, zbaton edukim të detyrueshëm për anëtarët e KKZ-ve

Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i KKZ-së janë të detyruar të marrin pjesë në edukimin që e organizon KSHZ-ja. Prania në edukim është e detyrueshme. Trajnimet janë të dimensionuara dhe të projektuara në mënyrë që sigurojnë dituri përkatëse edhe pas përfundimit të tyre, KKZ-ja t'i kryejë veprimet zgjedhore në afate të duhura, në mënyrë të përpiktë dhe profesionale.

Qëllimi i njërës nga punëtoritë është që përfaqësuesit e secilit KKZ të përfitojnë dituri dhe aftësi të duhur, që anëtarëve të KZ-së që janë nën kompetencat e tyre t'u përcjellin edukimin në mënyrë sa më kualitative. Për këtë qëllim posaçërisht duke pasur parasysh kualifikimet, aftësitë dhe para të gjithave dëshirën e tyre për tu bërë edukatorë të KZ-së, në adresën elektronike edukacija@sec.mk dërgoni porosinë e NOMINIMIT të përfaqësuesve të KKZ-së tuaj të cilët do të marrin pjesë në këtë punëtori dhe atë:

- për KKZ deri më 20 vendvotime- NJË PËRFAQËSUES
- për KKZ prej 21-50 vendvotime- DY PËRFAQËSUES dhe
- për KKZ mbi 50 vendvotime- TRE PËRFAQËSUES.

KSHZ-ja, pas mbarimit të edukimit të detyrueshëm, pjesëmarrësve të punëtorive iu ndanë certifikata për pjesëmarrje.

PUNA FINANCIARE E KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

Puna financiare të KKZ-së rrjedh sipas:

- UDHËZIMIT TË MËNYRËS SË REALIZIMIT TË MJETEVE TË PËRCAKTUARA NGA KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE NGA ANA E KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE
- RREGULLORES SË REALIZIMIT TË MJETEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE,

të miratuara nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve.

Udhëzimin dhe Rregulloren mund t'i gjeni në ueb faqen e KSHZ-së. Të njëjtat t'i lexoni me kujdes dhe rreptësisht përmbahuni dispozitave të tyre.

KOMPETENCAT LIDHUR ME KËSHILLAT ZGJEDHOR

FORMIMI I KËSHILLAVE ZGJEDHOR

1. PËRBËRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR

KZ-ja formohet për secilin vendvotim. KZ përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendës. Të gjithë janë me vendbanim në territorin e Komunës për të cilën është formuar KZ-ja. Në rast se në komunë nuk ka persona përkatës, në KZ, emërohen persona me vendbanim të përhershëm të ndonjë komune tjetër(më shpesh, komuna fqinje).

Kryetari i KZ-së, zëvendësi i tij, dy anëtarët dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike, komunale dhe administratën e Qytetit të Shkupit. Zgjedhja e kryetarit të KZ-së, zëvendësit kryetarit dy anëtarët dhe zëvendësanëtarët e kryen KKZ-ja, me ndihmën dhe përkrahjen e KSHZ-së. Zgjedhja kryhet me zgjedhje të rastit. Mënyra dhe procedura e zgjedhjes janë të rregulluara me Rregulloren e KSHZ-së.

ME RËNDËSI: *Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZ-së, patjetër duhet të jetë me arsimim sipërorë, ndërsa anëtarët dhe zëvendësanëtarët duhet të jenë minimum me arsimim të mesëm.*

Një anëtarë i KZ-së dhe zëvendësanëtari emërohen me propozimin e partive politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë fituar më së shumti vota, kurse një anëtarë dhe zëvendësanëtar emërohen me propozimin e partive politike të mazhorancës të cilët në zgjedhje parlamentare të fundit kanë fituar më së shumti vota.

Partitë politike për secilin cikël zgjedhorë për anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Këshillit Zgjedhor dorëzojnë propozime të reja.

Në rast se partitë politike nuk dorëzojnë propozimet e tyre në afatin e verifikuar në Kodin Zgjedhor, emërimin e anëtarëve e kryen KKZ-ja me zgjedhje të rastit , në pajtim me dispozitat e Kodit zgjedhor.

KKZ-ja duhet të ketë kujdes:

- Gjatë emërimit të anëtarëve të KZ-së, në komunat ku jetojnë së paku 20% e popullatës të bashkësive tjera, gjatë zgjedhjes shfaqet principi i përfaqësimit të drejtë përkatës për gjitha bashkësitë.
- Në përbërjen e secilit këshill zgjedhor secila gjini duhet të jetë e përfaqësuar së paku 30%.

KKZ-ja, gjatë formimit të këshillit zgjedhor përgatit Aktvendim për zgjedhje të Kryetarit, zëvendëskryetarit, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve. (Formulari nr. 9)

2. SHKAQET E MARRJES SË EMËRIMIT TË ANËTARIT TË ZGJEDHUR TË KZ

Personi i zgjedhur kryetar, zëvendëskryetar, anëtarë dhe zëvendësanëtari KZ-së ka të drejtë në mospranimin e kryerjes së detyrës vetëm për shkaqe shëndetësore ose familjare. Për marrjen e emërimit të personit nga përbërja e KZ-së vendos KKZ-janë baze të dokumentacionit të dorëzuar përkatës. Në këto raste KKZ-ja përgatitë aktvendim për ndryshim dhe plotësim të aktvendimit për formimin e KZ -së (Formulari 9a)

3. CILI NUK MUND TË JETË ANËTAR I KËSHILLIT ZGJEDHOR?

Anëtar i KZ-së nuk mund të zgjidhet:

- Person i dënuar me vepër penale lidhur me zgjedhjet,
- Person i cili më parë ka marrë pjesë në zbatimin e zgjedhjeve dhe në punën e tij si anëtarë i organit zgjedhor janë verifikuar parregullsi për të cilën është prishur votimi.
- Të zgjedhur ose i emëruar funksionarë në Qeveri, përkatësisht në Kuvend
- Persona të punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrinë e drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretariatin e Legjislaturës, Entin Shtetëror të Statistikës, Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Qendrën e Udhëheqjes me Krizat, Shërbimin Profesional të Gjykatës Administrative, Shërbimin Profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Shërbimin Profesional të Komisionit Shtetëror për Pengim të Korrupsionit dhe të punësuarit në Shërbimin Profesional të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuele.

4. SI VEPRON KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE?

1) KSHZ-ja, zgjedhjen e rastit të KZ-ve nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore dhe publike e organizon në lokalet e më parë të siguruara, në Shkup. Për ditën dhe orarin e zgjedhjes së rastit KSHZ–ja përgatit plan dhe orar dhe e njofton KKZ-në.
2) KKZ, menjëherë pas pranimit e të dhënave të KSHZ-së, dërgon njoftim partive politike për dorëzimin e propozimeve nga ana e tyre për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të KZ-së. (për Zgjedhjet presidenciale 2014 këtë obligim të KKZ-së e ndërmerr Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve)
3) Partitë politike propozimet e tyre për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të KZ-së, në KKZ i dorëzojnë në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit. Nëse partitë politike nuk e dorëzojnë propozimin në afat të paraparë, KKZ-ja emërimin e anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve e kryen me anë të zgjedhjes së rastit nga radhët e të punësuarve të administratës shtetërore, publike, komunale dhe administratës të qytetit të Shkupit
4) Në pajtim me udhëzimet dhe sqarimet e KSHZ. Çdo zëvendësim të anëtarit ose zëvendësanëtarit në përbërjen KZ-së kryhet me anë të zgjedhjes së rastit.

5) KKZ-ja, pas formimit, të KZ-së është e detyruar, të përgatitë aktvendime dhe të sigurojë deponim e nënshkrimeve të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të KZ-së. Nënshkrimet e kryetarit, zëvendëskryetarit, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve deponohen në Formularin numër 9 (kur emërohet përbërja e re e KZ-së) ose në Formular numër 9a (ku kryhet emërimi dhe plotësimi përbërjes së KZ-së). Këto dy formularë janë të miratuar nga ana e KSHZ-së dhe sipas nevojës mund të nxirren nga ueb faqja e internetit të KSHZ-se, www.sec.mk. KKZ-ja, KOPJET E AKTVENDIMEVE ME NËNSHKRIMET E DEPONUARA TË ANËTARËVE TË KZ-së, KKZ-ja i DORËZON NË KSHZ.

6) KKZ, në të njëjtën kohë bashkë me nënshkrimet e deponuara i merr të dhënat për llogarinë transaksionale dhe NUAQ të kryetarit, zëvendëskryetarit, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve. Këto të dhëna shënohen në formular të veçantë, të përpiluar nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, dhe të njëjtat i dorëzon në KSHZ. Në llogaritë e cekura transferohen kompensimi në të holla për angazhimin e tyre në KZ. Shuma e kompensimit është e përcaktuar me rregulloren e KSHZ-së.

7) KKZ-ja pas deponimit të nënshkrimeve është e detyruar që anëtarëve të porsaemëruar t'u sigurojë fshehtësi dhe siguri e të dhënave personale.

8) Vendimet për emërimin e anëtarëve të KZ-së shpallen në shtypin e shpalljeve të komunës dhe vendosen në tabelën e shpalljeve në komunë, në vende të hapura dhe në selinë e komunës dhe në KKZ.

9)Nuk lejohet ndryshimi i përbërjes së KZ-së pa e njoftuar më parë KSHZ-në. KKZ-ja, mund të kryen ndryshime dhe plotësime në përbërjen e KZ-ve, vetëm atëherë kur është miratuar aktvendimi i marrjes së emërimit për shkaqe shëndetësore ose familjare (të parapara me Kodin zgjedhor). KKZ-ja, në këto raste vepron në pajtim me rekomandimet e pranuara të KSHZ-së. Nëse ka pengesa të tjera objektive për punën e personit të emëruar të KZ-së, KKZ-ja menjëherë e njofton KSHZ-në dhe kërkon sugjerime për veprim.

PLANI DHE ORARI I EDUKIMIT TË DETYRUESHËM TË KËSHILLAVE ZGJEDHOR

EDUKIMI I KËSHILLAVE ZGJEDHOR ËSHTË SEGMENT KYÇ I RËNDËSISHËM NË PROCESIN ZGJEDHOR!

EDUKIMI DUHET TË JETË KUALITATIV DHE T'I PËRMBUSHË STANDARDET NDËRKOMBËTARE!

JU SI ANËTAR TË KKZ-së PËR KËTË JENI PËRGJEGJËS.

KKZ-ja, gjatë përgatitjes të planit dhe orarit për edukim të detyrueshëm të KZ-ve duhet të ketë parasysh disa parametra:

- Numrin e KZ-ve,
- Numrin e përgjithshëm të kryetarëve, zëvendëskryetarëve, anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve në kompetencat e KKZ-së,
- Numrin e personave të cilët do ta zbatojnë edukimin,
- Sigurimi i lokalit për edukim.

KSHZ-ja, menjëherë pas takimit të parë, rekomandon që KKZ-ja të organizojë takim me kryetarin e komunës, përkatësisht personin e autorizuar të komunës, që të sigurojë disa klasa në shkollën e territorit të komunës ku do të kryhet edukimi i detyrueshëm i KZ-ve.

Pastaj duke pasur parasysh gjitha parametrat, të përgatitet plani dhe orari i edukimit. Edukimi i detyrueshëm i KZ-së përfshin edukim njëditor për një KZ.

PLANIN E EDUKIMIT MENJËHERË DËRGOJENI NË ADRESËN ELEKTRONIKE edukacija@sec.mk!

Edukimin e zbatojnë përfaqësuesit e KKZ-së të cilët kanë qenë të pranishëm në trajnimin e trajnuesve, të zbatuar nga ana e KSHZ-së.

Edukimi është i detyrueshëm për të gjithë kryetarët, zëvendëskryetarët, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e KZ-ve.

KKZ-ja, pas mbarimit të edukimit të detyrueshëm, kryetarit, zëvendëskryetarit, anëtarëve, zëvendësanëtarëve të KZ-së, u ndanë certifikata për vizitën e edukimit të detyrueshëm. Formularët dhe certifikatat i siguron KSHZ-ja.

AKTVITETET TJERA NJË DITË PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

MENAXHIMI ME MATERIALIN ZGJEDHOR

Materiali zgjedhor ndahet në dy grupe:

- Material zgjedhor i besueshëm dhe
- Material zgjedhor jo i besueshëm.

MATERIALI ZGJEDHOR I BESUESHËM	MATERIALI ZGJEDHOR JO I BESUESHËM
1. Bllok amë (koçan) me fletëvotime 2. ekstrakt i Listës zgjedhore për vendvotimin 3. Marker - ngjyrë të dukshme (për gjurmim të votuesve të cilët kanë votuar); 4. ditar i evidencës së ngjarjeve për vendvotimin; 5. vulë me numrin e vendvotimit 6. formularë dhe procesverbal të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve: 7. Procesverbal për dorëzimin e materialit zgjedhor nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve të Këshillit Zgjedhor (Formulari numër 14a) 8. Procesverbal për verifikimin e gjendjes së lokalit për zgjedhje materialit zgjedhor dhe kutive të votimit nga këshilli zgjedhor (Formulari numër 15) 9. Procesverbal për votim,sumim dhe verifikim i rezulltateve të vendvotomit (Formulari numër 16 a) 10. për dorëzimin e materialit zgjedhor nga KZ të Komisionit komunal të zgjedhjeve (Formulari numër 20a) 11. për sumimin e rezultateve të komunës (formulari numër 21a) Sipas nevojës edhe këto formularë: 12. Procesverbal i veçantë i votimit të zgjedhësve të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit me burg ose në paraburgim (Formulari numër 18a) dhe 13. Procesverbal i veçantë i votimit të zgjedhësve me status të zhvendosur brenda vendit (Formulari numër 19a)	1. paravane zgjedhore; 2. lista e kandidatëve (pano informuese); 3. kuti votimi; 4. shirit sigurues plastik për mbylljen e kutisë së votimit dhe thes për transportin e materialit zgjedhor të besueshëm 5. zarfe për paketim, nga një për: • fletvotimet të përdorura (të vlefshme dhe të pavlefshme) • fletvotime të paperodrura • blloqet amë, lista zgjedhore dhe Ditari për evidencë të ngjarjeve; • një zarf mbrojtës rezervë; 6. thasë plastiku të mëdhenj, të tejdukshëm të veçuar me etiketë: • një thes për transportin e materialit zgjedhor të besueshëm; • një thes për transport të materialit zgjedhor jo të besueshëm; 7. etiketa ngjitëse për veçimin e thasëve për transport 8. material tjetër jo të besueshëm ku bënë pjesë: • stilolapse; • marker; • vizore; • mbështetës grafiku për markimin e gishtit; • bexhe për anëtarët e këshillit zgjedhor; • udhëzim për votim në shumë gjuhë • materiale tjera.

1. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NGA KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE NË KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

KSHZ-ja më së voni 72 orë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, KKZ-së ia dorëzon materialin zgjedhor.

Dorëzimi i materialit zgjedhor prej KSHZ-së në KKZ bëhet në këtë mënyrë:

- KSHZ-ja organizon transportin e materialit zgjedhor prej shtypshkronjës ku shtypet materiali zgjedhor deri në selinë e KKZ-së. KSHZ-ja një ditë më parë e njofton KKZ-në, afërsisht për kohën e dorëzimit dhe personin i cili do ta kryejë dorëzimin. KKZ-ja është e detyruar për ditën dhe kohën e dorëzimit të materialit zgjedhor të njoftojë policinë që me kohë të sigurohet materiali. Për ditën dhe kohën e dorëzimit të materialit zgjedhor informohen edhe përfaqësuesit e autorizuar të listave të kandidatëve.
- Për pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbal – Formulari numër 13 (për materialin zgjedhor të besueshëm) dhe Formulari numër 13a (për materialin zgjedhor jo të besueshëm).

Komisionit komunal të zgjedhjeve i dorëzohet materiali zgjedhor për të gjitha KZ-të që janë nën kompetencat e saja.

2. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NGA KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE NË KËSHILLAT ZGJEDHOR

KKZ-ja është e detyruar që KZ-ve që janë nën kompetencat e saja t'u dorëzojë materialin zgjedhor një ditë para ditës së përcaktuar të mbajtjen e zgjedhjeve. Për dorëzim-pranimin e materialit përpilohet Formulari nr. 14a.

KKZ-ja për dorëzimin e materialit zgjedhor KZ-ve:

- Përpilon plan aksional dhe orar për dorëzimin e materialit zgjedhor KZ-ve;
- Për kohën e dorëzimit i njofton kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZ-së
- Përpilon procesverbal për pranim -dorëzimin ndaras për secilin KZ. Këtë procesverbal e
- nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e KZ-së si dhe anëtari i KKZ-së i cili e dorëzon materialin.
- për ditën dhe kohën e dorëzimit të materialit e njofton policinë që të sigurojë kolonë për përcjelljen dhe sigurimin e materialit zgjedhor dhe të personave.
- është e detyrueshme për pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor ti njoftoj përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës. Nëse përfaqësuesit e autorizuar të listës për dorëzimin e materialit zgjedhor kanë vërejtje, ata kanë të drejtë që vërejtja e tyre të evidentohet në procesverbal. Këto vërejtje do të jenë bazë në procedurën e mbrojtjes e së drejtës zgjedhore. Nëse përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës vërejtjet e tyre nuk u evidentohen në procesverbalin për pranim-dorëzim të materialit zgjedhor, ata kanë të drejtë në afat prej 5 orëve pas nënshkrimit të procesverbalit vërejtjet e tyre t'i dorëzojnë në KKZ.
- Vëzhguesit e akreditуar gjithashtu kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë pranimit të materialit zgjedhor të njoftuar më parë për orarin e dorëzimit.

ME RËNDËSI: *në ato vendvotime ku nuk ka kushte që materiali zgjedhor të jetë i vendosur në lokal të posaçëm i cili mund të mbyllet, e detyrueshme është që materiali zgjedhor të vendoset në lokalet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.*

PRANIMI I NJOFTIMEVE PËR VOTIM TË PERSONAVE TË SËMURË OSE TË PAAFTË, PËRKATËSISHT PERSONA TË CILËT GJENDEN NË VUAJTJEN E MASAVE-BURG SHTËPIAK

Zgjedhësi i cili nuk është në gjendje të votojë në vendvotim(person i pa aftë ose i sëmurë) ndërsa ka dëshirë të votojë, për këtë në afat prej shtatë ditëve nga dita e përcaktuar e zgjedhjeve e njofton KKZ-në(deri më 5 prill 2014, në ora 24:00). Njoftimi mund të dorëzohet edhe me anë të personit të autorizuar dhe i njejti do të vlej për të dy rrethet zgjedhore.

Zgjedhësit të cilët në ditën e votimit gjenden në vuajtjen e dënimit të masave -burg shtëpiak , ndërsa duan të votojnë, për këtë në afat prej tre ditëve nga dita e përcaktuar e zgjedhjeve, me anë të personit të autorizuar e njofton KKZ-në (deri më 9 prill 2014, në ora 24:00)

Njoftimi duhet të përmbajë:

- EMRI DHE MBIEMRI i votuesit;
- DATËLINDJA e votuesit;
- ADRESA E BANIMIT (adresa sipas dokumenteve personale të votuesit sipas të cilëve është i regjistruar në Listën e veçantë zgjedhore);
- ADRESA NË TË CILËN VOTUESI DO TË VOTOJË (kjo mund të jetë e ndryshme nga adresa e banimit në këtë rast KZ votuesin e viziton në këtë adresë dhe këtu e zbaton votimin, por adresa patjetër të jetë ne territorin e komunës ku votohet.).
- NËNSHKRIMI i votuesit;
- DOKUMENTACIONI NË SHTOJCË (Dokumentacioni medicinal. Aktvendim për shfrytëzimin e kurimit të personit tjetër etj.- për person të paaftë ose të sëmurë).

KKZ pas skadimit të afatit (5 prill 2014, në ora 24:00), për persona të paaftë ose të sëmurë, përkatësisht (9 prill 2014, në ora 24:00), për persona të cilët janë në vuajtje të masave të dënimit-burg shtëpiak, në bazë të listës së pranuar më parë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për personat të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit të masave- burgut shtëpiak, KKZ-ja përpilon:

1) **LISTË TË PERSONAVE TË SËMURË OSE TË PAAFTË, TË CILËT DO TË VOTOJNË NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE. dhe**
2) **LISTË TË GJITHË PERSONAVE TË PARAQITUR TË CILËT GJENDEN NË VUAJTJEN E DËNIMIT TË MASAVE – BURG- SHTËPIAK.**

KKZ-ja në listë i përcakton personat sipas vendvotimit dhe gjatë pranim-dorëzim të materialit zgjedhor secili KZ pranon listë të vendvotimit për të cilin është kompetent.

KKZ-ja, për votimin e personave të sëmurë ose të paaftë dhe të personave të cilët janë në vuajtje të masave-burg shtëpiak, e njofton Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

AKTIVITETET NË DITËN E VOTIMIT

AKTIVITETET PARA FILLIMIT TË VOTIMIT

KKZ-ja, është e detyruar të sigurojë që të gjithë vendvotimet të jenë të hapura në orën 07:00. Për këtë gjë, një ditë para zgjedhjeve KKZ-ja organizon mbledhje ku kryetari, zëvendëskryetari anëtarët, zëvendësanëtarët dhe sekretari i KKZ-së, në mënyrë individuale ose ekipore ndërmjet vete i ndajnë vendvotimet.

Secili prej tyre është i detyruar që ditën e zgjedhjeve prej orës 06:00 deri në ora 07:00, nëpër vendvotimet e „veta" të kalojë një xhiro dhe të vërtetohet se të gjithë anëtarët e KZ-së gjenden në vendet e tyre, se vendvotimi është i rregulluar në mënyrë që votuesve u mundëson pa pengesa të votojnë, materiali zgjedhor është në gjendje të duhur dhe secila KZ ka gjithçka që është e nevojshme për zhvillimin e pandërprerë të votimit. Ky është momenti për dhënien e instruksioneve ose shpjegimeve të fundit KZ-së.

Secili anëtar i KKZ-së parashtron raportin e kryerjes së xhiros dhe gjendjen e vendvotimeve, KZ-të dhe materialit zgjedhor. Raporti hyn në raportin final të punës së KKZ-së.

KKZ-ja, është e detyruar që në KSHZ të dorëzojë njoftim në të cilin theksohen vendvotimet të cilat nuk kanë qenë të hapura në 07:00 si dhe shkaqet e mos-hapjes së tyre si dhe masat që janë ndërmarrë për evitimin e parregullsive.

Ora 06:00-07:00	-------->	Xhiro nëpër vendeve e votimit	-------->	Raportet individuale; Njoftim deri në KSHZ	-------->	Pjesa përbërëse e raportit final për punën e KKZ

AKTIVITETET NË PERIUDHËN PREJ ORËS 07:00 DERI NË ORA 19:00

1. BASHKËPUNIMI ME ORGANET TJERA ZGJEDHORE

KKZ-ja, gjatë ditës gjithnjë është në kontakt me këshillat zgjedhor dhe me KSHZ-ën.

KKZ-ja, gjatë tërë kohës së votimit jep udhëzime për punën e KZ-së dhe kontrollon punën e tyre. KKZ –ja, intervenon në të gjitha rastet ku konstatohet se është cenuar ligjshmëria e zbatimit të zgjedhjeve ose të udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KKZ-ja ose nga KSHZ-ja.

KKZ-ja, për zgjidhjen e çdo problemi mund të lajmërohet në KSHZ-në. Në ditën e zgjedhjeve në KSHZ formohet koll-qendër, në ueb faqen e internetit të KSHZ-së shfaqen numrat telefonik. Pas pranimit të instruksioneve të KSHZ-ës, KKZ-ja është e i obliguar ato ti zbatojë.

2. SHKARKIMI I ANËTARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR

KKZ-ja, i shkarkon anëtarët e KZ-së në raste të punës së tyre kundërligjore, si para ditës së zgjedhjeve veçanërisht në ditën e zgjedhjeve. KKZ-ja, për këtë rast përgatit procesverbal detal dhe të njëjtin e dorëzon në KSHZ. Në raport theksohet emri dhe mbiemri i anëtarit të KZ-së, i cili është i shkarkuar dhe shkaqet e shkarkimit të tij. Në shtojcë dorëzohet edhe kopje nga provat në bazë të të cilave KKZ-ja ka konstatuar punën kundërligjore.

KKZ-ja, sipas nevojës mund të kërkojë deklaratë nga anëtarët tjerë të KZ-së, përfaqësuesit e pranishëm të autorizuar e parashtruesve të listës së kandidatëve, vëzhguesit e akreditуar dhe nga votuesit, të cilët në atë moment janë ndodhur në vendvotim. KKZ-ja është e detyruar që kopjet e deklaratave t'i dorëzojë në KSHZ.

3. MBLEDHJA E TË DHËNAVE PËR DALJEN E VOTUESVE

KKZ-ja nga KZ-ët mbledhë të dhëna për daljen e votuesve. Këto të dhëna i sumon dhe të sumuara i dorëzon në KSHZ, ndërsa KSHZ-ja më parë thekson për cilën periudhë kohore KKZ-ja duhet të parashtrojë raport për daljen e votuesve. Zakonisht mbledhja e të dhënave bëhet tri herë gjatë ditës në ora 10:00, 13:00 dhe 17:00.

4. BASHKËPUNIMI ME VOTUESIT

KKZ-ja, në ditën e zgjedhjeve është e hapur për gjithë votuesit, të cilët do të kërkojnë ndihmë për realizimin e drejtës së tyre zgjedhore. Në rast se KKZ-ja nuk ka mundësi që ti ndihmojë ose problemi nuk është nën kompetencat e KKZ-së, është i detyruar që votuesin ta drejtojë në Njësinë rajonale më të afërt të KSHZ-së ose Zyrën e vendit të KSHZ-së ose drejtë në KSHZ.

5. ZBATIMI I VOTIMIT TË ZGJEDHËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Për zgjedhësit me nevoja të veçanta të cilët nuk mund të hynë në vendvotim për të votuar këshilli zgjedhor është i detyruar që këtyre personave në mënyrë përkatëse t'u mundësojë hyrjen në vendvotim për realizimin e të drejtës së tyre zgjedhore (Udhëzim për zbatim të nenit 112-a të Kodit Zgjedhor).

Nëse këta persona me vete nuk kanë sjellë person i cili do t'u ndihmonte gjatë hyrjes në vendvotim, Këshilli Zgjedhor në këtë rast është i detyruar të përcaktojë persona nga radhët e zgjedhësve që janë hasur në vendvotim, për t'i ndihmuar personit me nevoja të posaçme të hyjë dhe ta realizoj të drejtën e tij zgjedhore.

AKTIVITETET PAS PËRFUNDIMIT TË VOTIMIT

1. PRANIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

KZ-ja, është e obliguar më së voni në afat prej pesë orëve pas përfundimit të votimit procesverbalet dhe materialin tjetër zgjedhor t'i dorëzojë në KKZ.

KKZ-ja gjatë pranimit të materialit zgjedhor të KZ-ve përpilon procesverbal të veçantë (Formulari numër 20 a). Materialin zgjedhor në KKZ e dorëzon kryetari i KZ-së në përcjellje të anëtarëve të interesuar të KZ-së ose përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesve të listave, dhe nëse ka nevojë edhe në përcjellje të përfaqësuesve të policisë

KKZ-ja duhet të jetë e përgatitur në pritjen e materialeve të KZ-ve. Lokali ku KKZ-ja e pranon materialin duhet të jetë i papengueshëm dhe të jetë i rregulluar në mënyrë që:

- Hapi 1: Kryetari dhe shumica e anëtarëve të KKZ-së nga KZ-të i pranojnë dhe i kontrollojnë vulën me numër të vendvotimit, Markerët-ngjyrën e dukshme për gjurmim të votuesve dhe procesverbalet e sumimit. Nëse procesverbalet janë në mënyrë të drejtë të plotësuara, shumica e anëtarëve të KKZ-së e nënshkruajnë procesverbalin e dorëzimit të materialit zgjedhor dhe KZ-ja e lëshon lokalin. Një nga anëtarët ose zëvendësanëtarët mban evidencë se cila KZ i ka dorëzuar procesverbalet.
- Hapi 2: Një anëtarë ose zëvendësanëtarë i KKZ-së nga KZ-të i pranon kutitë e zbrazura të votimit dhe thasët me materialin zgjedhor të besueshëm dhe jo të besueshëm, gjithashtu, mbanë evidencë se cila nga KZ-të i ka dorëzuar. KKZ-ja gjatë kësaj duhet të ketë kujdes dhe të vërtetohet se ekstrakti i Listës zgjedhore dhe Ditari i evidencës së ngjarjeve janë të paketuar bashkë me materialin tjetër të besueshëm zgjedhor dhe gjendet brenda në thes!

Nëse Këshilli Zgjedhor nuk përfundon me hapin e parë, nuk mund t'i qaset hapit të dytë, të dorëzimit të materialit.

Secila KKZ, pranimin e materialit zgjedhor e organizon në pajtim me kushtet që disponon.

Pas pranimit të procesverbaleve nga KZ-të për sumimin e rezultateve, rezultatet lexohen publikisht para të pranishmëve (përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve, vëzhguesit e akreditуar gazetarët, anëtarët e pranishëm të këshillit zgjedhor).

Nëse procesverbali nuk është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Këshillit Zgjedhor, i njëjti në bazë të materialit të tërësishëm zgjedhor, plotësohet dhe nënshkruhet nga ana e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.

Në çdo KKZ, varësisht nga numri i vendvotimeve, nga ana e KSHZ-së dërgohen operator të trajnuar me kompjuter laptop, që në mënyrë elektronike do ti përcjellin të dhënat e votimit në KSHZ. Pas leximit të procesverbalit nga ana e sekretarit, zëvendëssekretarit të KKZ-së, procesverbali i dorëzohet operatorit i cili rezultatet i regjistron në sistemin e evidencës së rezultateve të KSHZ-së.

2. SUMIMI DHE KONFIRMIMI I REZULTATEVE

1. SUMIMI I REZULTATEVE NGA VOTIMI NËPËR VENDVOTIME

KKZ-ja në afat prej 5 orëve nga pranimi i materialit të tërësishëm zgjedhor nga KZ-të për të cilët është kompetent, i sumon rezultatet e votimit të listave të kandidatëve, për komunën përkatëse.

Në çdo KKZ, varësisht nga numri i vendvotimeve, nga ana e KSHZ-së dërgohen operator të trajnuar me kompjuter laptop, që në mënyrë elektronike do t'i përcjellin të dhënat e votimit në KSHZ.

Pas pranimit të procesverbaleve nga KZ-të për sumimin e rezultateve, rezultatet lexohen publikisht para të pranishmëve (përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve, vëzhguesit e akreditуar gazetarët, anëtarët e pranishëm të këshillit zgjedhor dhe personave të tjerë të cilët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në punën e Komisionit).

Pasi procesverbali të lexohet, sekretari i KKZ-së ose zëvendësi i tij, ia dorëzon operatorit, i cili rezultatet i regjistron në sistemin e evidencës së rezultateve të KSHZ-së.

Pasi operatori i regjistron në sistem rezultatet e gjitha vendvotimeve për të cilat është kompetente KKZ-ja, rezultatet sumohen dhe menjëherë shtypen.

2. PROCESVERBALI PËR VOTIMIN, FORMULARI NUMËR 21a

Operatori pasi i shënon rezultatet nga të gjitha vendvotimet e KKZ-së kompetente në sistemin e rezultateve, rezultatet menjëherë sumohen në nivel komunal dhe këto rezultate të sistemit shtypen.

Kryetari para të pranishmëve i lexon rezultatet dhe pastaj e plotëson procesverbalin (Formulari numër 21a). Në procesverbal për votim shënohen të dhënat nga sumimi i votave nga votimi dhe atë:

Numri rendor i vendvotimeve për të cilat KKZ-ja është kompetente

- Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në ekstraktet e Listës zgjedhore për këto vendvotime
- Numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar,
- Numri i përgjithshëm i personave që gjenden ne burg ose paraburgim që kanë votuar,
- Numri i përgjithshëm i personave me status të zhvendosur brenda vendit që kanë votuar,
- Numri i përgjithshëm i personave të sëmurë dhe të paaftë të cilët kanë votuar dhe i personave të cilët vuajnë masat-burg shtëpiak,
- Numri i përgjithshëm i personave të emëruar për anëtar të KZ-ve në PDK, që kanë votuar.

Në internet faqen e KSHZ-së www.sec.mk gjejeni:

1. Procesverbalin për sumimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar të Republikës së Maqedonisë (Formulari numër 16a), dhe
2. Procesverbalin për konfirmimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar të Republikës së Maqedonisë (Formulari numër 21a),

Bashkë me udhëzimet për plotësimin e tyre, PARA SE TA PLOTËSONI PROCESVERBALIN UDHËZIMET LEXONI ME KUJDES!

- Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme dhe
- Numri i përgjithshëm i votave të fituara që ka fituar secila listë e kandidatëve, në nivel të komunës nga vendvotimet për të cilën është kompetent Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e KKZ-së. Procesverbali është i vlefshëm nëse e nënshkruajnë shumica e anëtarëve të KKZ-së. Kryetari i KKZ-së, duhet t'i theksojë shkaqet për mosnënshkrimin e procesverbalit nga ana e anëtarit të komisionit. Nëse përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave kanë vërejtje, kryetari i KKZ është i detyruar që t'u mundësojë që këto t'i evidentojë në procesverbal. Vërejtjet e evidentuara janë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

Secilit përfaqësues të parashtruesit të listës dhe vëzhguesve të pranishëm të akreditуar u jepet ekzemplar nga procesverbali.

PAKETIMI I MATERIALEVE PËR DORËZIM NË KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

- KKZ-ja, pas sumimit të rezultateve nga votimi, e plotëson Procesverbalin për votim (Formulari numër 21a). Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit Komunal Të Zgjedhjeve.
- KKZ-ja, pastaj i plotëson dhe i nënshkruan kopjet e karbonizuara nga Formulari numër 21a. KKZ-ja secilit përfaqësues të autorizuar të parashtruesve të listës së kandidatëve që janë të pranishëm në lokale e KKZ, i jep nga një kopje të karbonizuar nga formulari numër 21a.
- Plotëson Procesverbalin për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari 22a)
- Pastaj kalon në paketimin e materialit zgjedhor.
- Në fund në mënyrë të organizuar me përcjellje të policisë drejtohet për në KSHZ që ta dorëzojë materialin zgjedhor.

KKZ-ja në KSHZ dorëzon vetëm materialin e besueshëm zgjedhor dhe atë :

1) Thasët plastik të tejdukshëm për transportimin e materialit të besueshëm, të cilëve iu është ngjitur shirit ngjitës me emrin e komunës, llojit të zgjedhjeve dhe numrit të vendvotimit,
2) Procesverbalet origjinal nga sumimi i rezultateve(formulari numër 16a),
3) Procesverbali origjinal për votim (formulari numër 21a) dhe
4) Vulat me numër të vendvotimeve dhe
5) Markerët-me ngjyrë të dukshme për markimin e votuesve.

Thasët e tejdukshëm plastik për transportimin e materialit të besueshëm, në të cilët është ngjitur shiriti ngjitës me emrin e komunës, llojin e zgjedhjeve dhe numrin e vendvotimit ngarkohen në automjet për transportim, ku KKZ e siguron sipas nevojave të veta.

Vulat me numër të vendvotimit i dorëzohen personit të autorizuar të KSHZ-së.

Procesverbali origjinal për votim (Formulari numër 21a), Procesverbalet origjinal nga sumimi i rezultateve (Formulari 16a) në zarf të veçantë dorëzohen në KSHZ. Këto procesverbale i dorëzohen KSHZ-së.

Në Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve, dorëzohen edhe markerët-me ngjyrë të dukshme për markimin e votuesve.

Kutitë e votimit dhe thasët e tejdukshëm plastik në të cilët nuk ka shirit ngjitës ku KZ-ja ka paketuar materialin tjetër jo të besueshëm, ruhen në lokalet e KKZ-së. KSHZ-ja pas përfundimit të zgjedhjeve, me harxhimet e veta në mënyrë të organizuar di t'i merr këto materiale nga KKZ-ja.

ME RËNDËSI: *Kryetari i Komisionit Komunal të Zgjedhje është i detyruar që me vete të mbajë edhe vulën e KKZ-së!!!*

KKZ-ja, materialin zgjedhor deri në KSHZ e dorëzon në përbërje të tërësishme, përkatësisht kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i KKZ-së.

Policia gjatë tërë kohës së transportimit e siguron KKZ-në dhe materialin e votimit, përkatësisht deri në selinë e KSHZ-së.

KKZ-ja pas arritjes para selisë së KSHZ-së e lajmëron arritjen para personit të autorizuar të KSHZ-së dhe në mënyrë të rregullt pret rend për dorëzimin e materialit zgjedhor dhe të procesverbaleve.

KKZ-ja, në rastë se në KSHZ i sjell me vete edhe kutitë e votimit dhe thasët e tejdukshëm plastik në cilët nuk kanë shirit ngjitës dhe në të cilët KZ-ja ka paketuar materialin tjetër jo të besueshëm, këto materiale nuk do të pranohen ose KSHZ-ja do t'i pranojë vetëm thasët me material zgjedhor të besueshëm dhe procesverbalet, ndërsa kutitë e votimit dhe materialin jo të besueshëm KKZ-ja është e detyruar ta kthej në selinë e vet me harxhime të veta.

KONTRIBUTI I KKZ-së NË MBROJTJEN E TË DREJTËS ZGJEDHORE

KKZ-ja, gjasat e zbatimit të edukimit të KZ-ve, duhet të theksojë se kryetari i Këshillit Zgjedhor është i DETYRUAR DHE I OBLIGUAR që përfaqësuesve të pranishëm të parashtruesve të listave në rast se kanë vërejtje, atyre t'u mundësojë që vërejtjet e tyre të evidentohen në procesverbal dhe këto të jenë bazë në procedurën e mbrojtjes së të drejtës zgjedhore.

Në rast se vërejtja e përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesit të listës nuk evidentohet në procesverbal, atëherë ai ka të drejtë në afat prej 5 orëve pas nënshkrimit të procesverbalit, vërejtjet t'i dorëzojë në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve.

Në rast se vëzhguesit e akreditуar kanë vërejtje në punën e Këshillit Zgjedhor, kanë të drejtë që vërejtjet e tyre t'i evidentojnë në Ditarin e vendvotimit.

Gjithashtu, edhe kryetari i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve është i DETYRUAR DHE I OBLIGUAR që përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesve të listës nëse kanë vërejtje, t'u mundësojë që ato të evidentohen në procesverbal dhe të jenë bazë e procedurës për mbrojtjen e së drejtës zgjedhore.

Ekzemplar të procesverbalit merr secili përfaqësues i autorizuar i parashtruesit të listës dhe vëzhguesit e akreditуar.